



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 07.03.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “MJEDISE SHITESË TË  
AKTIVITETIT INDUSTRIAL PËR PRODHIMIN E LËNDËVE PLASËSE PËR  
PËRDORIM CIVIL”, ME VENDNDODHJE NË KAKAVIJË, BASHKIA DROPULL,  
QARKU GJIROKASTËR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt kërkues “Vagexco” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Mjedise shtesë të aktivitetit industrial për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil”, me vendndodhje në Kakavijë, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë, me subjekt kërkues shoqërinë “Vagexco” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**



**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**